

EPPC Albania kërkon një **Legal & Compliance Officer** për klientin e saj, kompani lider në fushën e kujdesit shëndetësor.

Përgjegjësitë kryesore:

- Sigurimi që aktivitetet e biznesit të kryhen në përputhje me të gjitha ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat e brëndshme të aplikueshme;
- Sigurimi që të gjitha lejet rregullore të jenë aktuale dhe të përshtatshme për nevojat e biznesit;
- Vlerësimi i vazhdueshëm i riskut të përputhshmërisë së praktikave të kompanisë së bashku me zhvillimin e politikave dhe procedurave të brendshme, trajnimin dhe protokollet e përputhshmërisë;
- Mbajtja e marrëdhënieve me organet rregullore dhe palët e 3-ta;
- Të mbajë të informuar mbi zhvillimet rregullore dhe iniciativat e industrisë dhe të këshillojë menaxhmentin në përputhje me to;
- Sigurimi i raportimeve në lidhje me kërkesat dhe zhvillimet rregullore;
- Përgatitja e dokumentacionit të përputhshmërisë me dokumentet përbërëse për qëllime ligjore dhe rregullore;
- Bashkëpunim me ofruesit e shërbimeve, këshilltarët ligjorë të jashtëm dhe agjencitë qeveritare;
- Zhvillimi dhe mbikëqyrja që kompania të përmbushë detyrimet e saj të përputhshmërisë sipas ligjeve përkatëse dhe kërkesave të autoriteteve rregullore;
- Negocimi, hartimi dhe zbatimi i kushteve të marrëveshjeve në të gjitha kontratat dhe marrëveshjet e biznesit;
- Përgjegjës për sigurimin e mbështetjes ligjore në kontrollin e ankesave të klientëve për të zvogëluar rrezikun e padive.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Bachelor në Drejtësi;
- Përvojë e mëparshme pune në përputhshmëri (Përvoja në sektorin e kujdesit shëndetësor e preferueshme);
- Përvojë në zhvillimin dhe menaxhimin e programeve të monitorimit të përputhshmërisë;
- Aftësi shumë të mira komunikuese dhe bashkëpunuese brenda dhe jashtë (avokatë, rregullatorë, auditorë, institucione shtetërore) në të gjitha nivelet;
- Njohës i gjuhës angleze;
- Aftësi shumë të mira organizuese, i aftë për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në grup.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun që vijon:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.